

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6511
E shtunë, 15 janar 2022
çmimi 0.40 €

Kosova regjistron 585 raste të reja me Covid

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

REPUBLIKA E KOSOVËS REFUZON KËRKESËN E SHBA-SË DHE TË BE-SË PËR
LEJIMIN E MBAJTJES SË REFERENDUMIT TË SERBISË NË KOSOVË

FAQE 4-5

POZITA DHE OPOZITA I THONË JO REFERENDUMIT TË SERBISË NË KOSOVË



Kosova e ka refuzuar kërkesën e bashkësisë ndërkombëtare për mbajtjen e referendimit kushtetues të Serbisë në Kosovë. Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, pas takimit që kanë pasur me ambasadorët e vendeve të Quintit dhe përfaqësuesin e BE-së, kanë vlerësuar se mbajtja e këtij referendimi në territorin e Kosovës përbën shkelje të qartë të Kushtetutës dhe të ligjeve të Kosovës si dhe të praktikave ndërkombëtare. Në një vijë me institucionet janë shprehur edhe tri subjektet politike opozitare, ndërsa sot (e shtunë) Kuvendi i Kosovës do të mbajë seancë të jashtëzakonshme në të cilën pritet të diskutohet për këtë çështje

AKTUALE



KOREJA E VERIUT KRYEN TESTIME TË REJA TË RAKETAVE BALISTIKE

F. 2

MASHTI DISKUTON ME PARTNERËT ZHVILLIMORË PËR DRAFTIN E PLANIT STRATEGJIK TË ARSIMIT 2002-2026

F. 7

KRYETARI I SKENDERAJT VLERËSON HUMANIZMIN E HALIL KASTRATIT

F. 6

EKONOMI



GASTRONOMËT E GJILANIT KËRKOJNË PËRKRAHJE NGA KOMUNA

F. 8

KOSOVA E DYTA NË RAJON SA I PËRKET RRIJTJES EKONOMIKE PËR DY VITET E ARDHSHE

F. 8

SPORT



SOT DY NDESHJE, NESËR DERBI PRISHTINA - PEJA

F. 10

Blinken, Kurtit: Shpresojmë për rikthimin e momentumit në dialog



January 11, 2022
His Excellency
Albin Kurti
Prime Minister
of the Republic of Kosovo
Pristina
Dear Mr. Prime Minister:
The United States and Kosovo enjoy a relations values and a commitment to a sovereign, indept hosting Afghans awaiting resettlement, Kosovo United States and others can rely upon. Similias 2021 co-deployment with the U.S. Army in Kap capacity to contribute to global security.
As Kosovo's friend and partner, the United Stat you to realize the full agenda President Biden is including strengthening the rule of law, protecti Sustaining economic growth, and securing a long between Kosovo and Serbia centered on mutual
The unresolved nature of Kosovo-Serbia relatio Kosovo's full membership and integration into I institutions, a goal the United States shares with facilitated dialogue remains the best forum for e Belgrade and Pristina, and we closely coordinat

FAQE 3



QALAJ: POLICIA E KOSOVËS NUK U LEJUA TA HETOJË RASTIN E DOSJEVE NË OVLUÇK

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Poroshenko nuk shqetësohet nëse do të arrestohet pas kthimit në Ukrainë

KIEVI, 14 JANAR - Ish-presidenti ukrainas Petro Poroshenko, i cili është larguar nga Ukraina në muajin dhjetor, ka thënë se do të kthehet atje pavarësisht prej thashethemeve se do të arrestohet menjëherë për akuza të lidhura me dyshimet për tradhti.

Poroshenko ka thënë në një intervistë për televizionin "Current Time", se hetuesit kanë tentuar të krijojnë rast kundër tij se u ka ndihmuar separatistëve për të shitur thëngjill në Ukrainë në vlerë të 54 milionë dollarëve më 2014. "Nuk do të përfundoj mbropa grilave, nuk do të kenë aq

kurajë, forcë apo gatishmëri për të vepruar ashtu", ka thënë ai, kur ka diskutuar nëse beson se do të arrestohet sapo të arrijë në Ukrainë gjatë këtij muaji. "Po kthehem jo për të mbrojtur veten nga (presidenti Volodymyr) Zelenskyi, por ta mbroj Ukrainën... ne duhet ta mbrojmë Ukrainën nga (presidenti rus, Vladimir) Putini, ta mbrojmë shtetin nga autoritetet jokompetente, të kalbura dhe absolutisht të korruptuara", ka thënë ai.

Në muajin dhjetor, Byroja Shtetërore për Hetime, ka thënë se Poroshenko është duke u

hetuar zyrtarisht për tradhti, pas akuzave se ai ka "ndërmjetësuar aktivitete" të separatistëve që luftojnë me forcat qeveritare në lindje të Ukrainës nga viti 2014.

Si pasojë e luftimeve kanë vdekur më shumë se 13 200 njerëz.

Poroshenko hedh poshtë akuzat dhe i konsideron të motivuara politikisht.

Më 6 janar autoritetet ukrainase kanë thënë se një gjykatë në Kiev ka ngrirë pronën e Poroshenkos në kuadër të hetimeve zyrtare.

Ish-presidenti 56-vjeçar i cili është ligjvënës dhe lider i partisë opozitare, Solidariteti Evropian, ka mohuar të gjitha pretendimet



dhe ka akuzuar autoritetet ukrainase se po kalojnë "vijën e kuqe", duke akuzuar ish-kreun e

shtetit për tradhti. Nëse dënohet, ai përballet me burgim deri në 15 vjet.

Koreja e Veriut kryen testime të reja të raketave balistike



PHENIAN, 14 JANAR - Koreja e Veriut ka lëshuar dy raketa të tjera balistike më 14 janar. Ky është testimi i tretë i raketave balistike që ky shtet ka bërë brenda dy javësh. Njoftimi për testimet e reja erdhi pasi Shtetet e Bashkuara vendosën sanksione të reja ndaj Phenianit.

Koreja e Jugut tha se ka detektuar ato që tha se dukeshin si dy raketa balistike me rreze të shkurtër veprimi. Sipas Koresë së Jugut, raketat u lëshuan në lindje nga Provinca Pyong, që gjendet në bregun perëndimor të Koresë së Veriut.

Ndërkaq, garda bregdetare e Japonisë raportoi se Veriu lëshoi atë që duhej se ishte raketë balistike. Raketat e lëshuara ranë në det jashtë zonës ekskluzive ekonomike të Japonisë, raportoi media NHK, duke e cituar një zyrtar të pidentifikuar nga Ministrja e Mbrojtjes së Japonisë.

Koreja e Veriut ka argumentuar se

testimi i raketave është e drejtë legjitime për vetëmbrojtje dhe ka thënë se SHBA-ja me qëllim po e përshkallëzon situatën duke vendosur sanksione të reja, raportoi media shtetërore më 14 janar, duke cituar Ministrinë e Jashtme.

Më 12 janar ShBA-ja vendosi sanksione të reja ndaj Koresë së Veriut për shkak të testimeve të fundit të raketave balistike. Uashingtoni i ka bërë thirrje Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që të vendosë sanksione të reja, pasi tha se testimet e fundit shkelin rezolutat e këtij Këshilli.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se ShBA-ja e ka bërë të qartë se nuk ka qëllime armiqësore ndaj Koresë së Veriut dhe se është e gatshme të angazhohet në bisedime pa parakushte, por tha se testimet ishin "thelësisht destabilizuese".

Armenia pret përmirësim të raporteve me Turqinë

JEREVANI, 14 JANAR - Armenia pret që të vendosen raportet diplomatike me Turqinë dhe kufijtë mes dy shteteve të hapen si rezultat i bisedimeve për normalizimin e raporteve. Bisedimet do të nisnin më 14 janar në Moskë, kanë njoftuar zyrtarë të Ministrisë së Jashtme të Armenisë.

Të dy shtetet vitin e kaluar kanë emëruar përfaqësues të posaçëm për normalizimin e marrëdhënieve dhe po kërkojnë që t'i përmirësojnë raportet pas tensionimeve disavjeçare. Raundi i parë i bisedimeve pritet të nisë si pjesë e një përpjekje më të gjerë për paqe rajonale në rajonin e Kaukazit Jugor, nën ndërmjetësimin e

Rusisë. "Sipas mendimit tonë, qeveria turke gjithashtu ndan qasjen për nisjen e dialogut pa parakushte", tha Vahan Hunanyan, zëdhënës i Ministrisë së Jashtme armene.

Hunanyan theksoi se Rusia do të jetë nikoqire e takimit dhe raundi i parë i bisedimeve do të jetë i natyrës eksploruese. "Është e vështirë të pritet që si rezultat i një takimi të mund të arrihen rezultate të prekshme, por procesi do të nisë", tha ai.

Në dhjetor të vitit 2021 Jerevani dhe Ankara njoftuan se do të emërojnë përfaqësues të posaçëm që do të udhëheqin bisedimet. Ish-ambasadori turk në Shtetet e

Bashkuara, Serdar Kilic, do ta përfaqësojë Ankarën dhe zëvendëskryetari i Asamblesë Kombëtare të Armenisë, Ruben Rubinian, do t'i udhëheqë bisedimet për palën armene.

Pas emërimit të përfaqësuesve të posaçëm, Armenia hoqi ndalesën për importin e mallrave turke dhe Turqia njoftoi se do të lejohen fluturimet për në Armeni.


Kryeministri i Armenisë, Nikol Pashinian dhe presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, gjithashtu kanë zhvilluar një sërë rundesh të bisedimeve me Bashkimin Evropian dhe me ndërmjetësimin e Rusisë, që prej luftës së vitit 2020 për rajonin e



Nagorno-Karabakhut. Raportet në mes të Armenisë dhe Turqisë historikisht kanë qenë të komplikuar lidhur me vrasjen e vitit 1915 të armenëve nga otomanët. Por, lufta ndërmjet

separatistëve armenë dhe Azerbajxhanit mbi rajonin e Nagorno-Karabakhut gjatë ndarjes së Bashkimit Sovjetik më 1991, përkeqësoi raportet në mes të Ankarasë dhe Jerevanit.

Blinken, Kurtit: Shpresojmë për rikthimin e momentumit në dialog



**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 JANAR- Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se shpreson që të rikthehet momentumit në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe që Kosova t'i mbështetë zotimet paraprake. Ai e ka bërë këtë deklaratë në një letër drejtuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar Qeveria e Kosovës më 13 janar.

Blinken ka thënë se ShBA-ja pret të bashkëpunojë me Kosovën në fushën e sundimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të

minoriteteve, nxitjen e rritjes ekonomike dhe arritjen e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, me fokus në njohjen e ndërsjellë.

Sipas sekretarit amerikan, natyra e pazgjidhur e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet pengesë për anëtarësimin dhe integrimin e plotë në institucionet evropiane dhe euroatlantike. "Besojmë që dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mbetet forumi më i mirë për normalizimin e negociatave ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe ne koordinohemi nga afër me partnerët tanë në BE

për këtë qëllim", ka thënë ai përmes letrës.

Blinken ka bërë thirrje për shmangie të veprimeve dhe retorikës që mund t'i rrisë tensionet. "Ju inkurajoj që t'i kushtoni vëmendje arritjes së marrëveshjes për energji elektrike në veriun e Kosovës dhe për avancimin e qëllimeve të përbashkëta në lidhje me personat e pagjetur. Është në interes të Kosovës që këto çështje të zgjidhen dhe të çojnë drejt një zgjidhjeje kompromisi në planin afatshkurtër e që të mund të shërbejnë si bazë për përparimin e mëtejshëm drejt normalizimit gjithëpërfshirës", ka shkruar ai.

Blinken ka theksuar se mbështetja e vendimeve gjyqësore, në veçanti vendimeve që ndërlidhen me të drejtat e minoriteteve, do të kishte efekt të ngjashëm pozitiv dhe është në harmoni me prioritetet e Qeverisë së Kosovës për fuqizimin e sundimit të ligjit.

Blinken ka përmendur në letër edhe ambasadorin e ri amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier dhe përfaqësuesin e posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, si persona që mund t'i ndihmojnë Kosovës që t'i adresojë çështjet e përmendura. "Ju lutemi të punoni ngushtë me ambasadorin

Hovenier dhe përfaqësuesin special të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, sepse të dy janë plotësisht të autorizuar për t'i adresuar këto çështje me ju. Të dy janë të përgatitur për t'i diskutuar specifikat me ju dhe ekipin tuaj. Jemi të gatshëm ta ndihmojmë Kosovën për t'i arritur qëllimet e përbashkëta", ka përmbyllur letrën dërguar kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, sekretari i shtetit i ShBA-së, Antony S. Blinken.

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka mirëpritur letrën nga sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken. "Unë e mirëpres letrën e sekretarit Blinken dhe mbështetjen e tij për prioritetet tona në punësim dhe drejtësi. Kosova i është mirënjohëse ShBA-së për përkushtimin për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes një marrëveshjeje ligjërishit të detyrueshme me qëllim final njohjen reciproke", ka shkruar Kurti në "Twitter".

Jeffrey Hovenier pason Philip Kosnett në postin e ambasadorit në Kosovë.

Hovenier është diplomat karriere i shërbimit të jashtëm amerikan i cili ka qenë pjesë e stafit të të dërguarit të posaçëm të Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës.

Mandati i ambasadorit të ShBA-së në Prishtinë është tre vjet.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, ka nisur më 2011 në Bruksel. Më 2021, në kuadër të dialogut, janë zhvilluar vetëm dy takime të nivelit të lartë në mes të kryeministrit Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq.

Qalaj: Policia e Kosovës nuk u lejua të hetojë rastin e dosjeve në OVLUÇK

HAGË, 14 JANAR (ER) - Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka dhënë dëshminë e tij të premtën para Dhomave të Specializuara në Hagë në gjykimin ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Para trupit gjyqësor Qalaj ka thënë se zyrtarët e OVLUÇK-së kishin kërkuar nga Policia e Kosovës që ta hetojë rastin me dokumentet që dërgoheshin nga një person i panjohur në organizatë, por Prokuroria Speciale e Kosovës ka thënë se policia nuk mund të merret me këtë rast meqë i njëjti është kompetencë e Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë.

Qalaj ka thënë se hetuesit e Policisë së Kosovës u janë përgjigjur thirrjes së zyrtarëve të organizatës dhe të njëjtët kanë kontaktuar drejtorin e Departamentit për Hetime në

Policinë e Kosovës, i cili, sipas tij, ka kontaktuar me prokurorin e Prokurorisë Speciale në Kosovës, i cili i ka thënë se PK nuk mund të hapë rast në këtë çështje. "Hetuesit të cilët kanë qenë në zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pasi që u është bërë kërkesë nga zyrtarët e kësaj organizate për hetimin e këtij rasti, për hapjen e rastit, kanë kontaktuar fillimisht nëpërmjet zinxhirit komandues me drejtorin e Departamentit për Hetime në Policinë e Kosovës i cili pastaj ka kontaktuar me prokurorin e Prokurorisë Speciale të Kosovës i cili ka qenë duke zëvendësuar kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale meqenëse ai ka qenë i sëmurë, më duket për shkak të pasojave të Covidit, dhe nga ai ka marrë përgjigjen që Policia e Kosovës nuk mund të hetojë këtë



rast për shkak se ky rast bie në kompetencat e zyrave të specializuara këtu në Hagë", ka thënë Qalaj.

Qalaj, derisa u është përgjigjur pyetjeve të avokatit mbrojtës të Haradinajt, ka thënë se kjo është hera e parë që ZPS nuk ka pasur asnjë komunikim zyrtar me

Policinë e Kosovës. Ish-drejtori i Policisë së Kosovës ka thënë se gjatë periudhës që lidhet me dërgimin e dokumenteve në OVLUÇK apo të sekuestrimit të tyre, ZPS nuk e ka kontaktuar Policinë e Kosovës, përveç në ditën e 25 shtatorit kur i është kërkuar PK-së që ta menaxhojë

turmën që ishte mbledhur para zyrave të OVLUÇK-së. Qalaj ka thënë se Policia e Kosovës nuk ka qenë brenda gjatë bastisjes në OVLUÇK në shtator të vitit 2020, veçse ka bërë sigurimin e jashtëm të ndërtesës, derisa bastisja ishte bërë nga EULEX-i dhe hetuesit e Speciales.



REPUBLIKA E KOSOVËS REFUZON KËRKESËN E SHBA-së DHE TË BE-së PËR LEJIMIN E MBAJTJES SË REFERENDUMIT TË SERBISË NË KOSOVË

Pozita dhe opozita i thonë jo referendumit të Serbisë në Kosovë

Kosova e ka refuzuar kërkesën e bashkësisë ndërkombëtare për mbajtjen e referendumit kushtetues të Serbisë në Kosovë. Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, pas takimit që kanë pasur me ambasadorët e vendeve të Quintit dhe përfaqësuesin e BE-së, kanë vlerësuar se mbajtja e këtij referendumi në territorin e Kosovës përbën shkelje të qartë të Kushtetutës dhe të ligjeve të Kosovës si dhe të praktikave ndërkombëtare. Në një vijë me institucionet janë shprehur edhe tri subjektet politike opozitare, ndërsa sot (e shtunë) Kuvendi i Kosovës do të mbajë seancë të jashtëzakonshme në të cilën pritet të diskutohet për këtë çështje

Ndryshimet kanë të bëjnë me gjyqësorin dhe Serbia është e obliguar për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe kryeparlamentari Glauk Konjufca kanë kërkuar nga aleatët ndërkombëtarë që në raport me Kosovën të aplikohen standarde të njëjta sikurse me çdo shtet tjetër. "Përveçse u ritheksua se qytetarët serbë të Kosovës me dyshetësi do ta kenë të drejtën të votojnë në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, pra nëpërmjet postës dhe në Zyrën Ndërlidhëse, institucionet bënë të qartë se hapja e qendrave të votimit të Serbisë në territorin e Kosovës përbën shkelje të qartë të Kushtetutës dhe të ligjeve të Kosovës si dhe të praktikave ndërkombëtare. Për më tepër, një akt i tillë është shkelje e integritetit territorial nga ana e Serbisë në raport me shtetin e

pavarur e sovran të Kosovës. Institucionet i kanë bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që në raport me Kosovën të aplikohen standarde të njëjta sikurse me çdo shtet tjetër meqë pavarësia e shtetit tonë jo vetëm që është njohur nga shumica e vendeve demokratike anekënd botës, por edhe është vulosur nga GjND-ja", është thënë në komunikatën e përbashkët të tri institucioneve qendrore të Kosovës.

Sipas udhëheqësve të Kosovës, praktika ndërkombëtare nuk njeh të drejtën e një shteti për të realizuar referendum në territorin sovran të një shteti tjetër. "Kushtetuta e Kosovës, ligjet e aplikueshme në Kosovë si dhe drejta ndërkombëtare dhe praktika ndërkombëtare nuk e njohin të drejtën e një shteti për të realizuar referendum në territorin sovran të një shteti tjetër. Prandaj, praktikat e deritanishme të aplikuara që nga viti 2012 kanë qenë

kundërkushtetuese e, si rrjedhojë, nuk i obligojnë institucionet e tanishme të Republikës së Kosovës të dalin nga vullneti i qartë i qytetarëve i shprehur më 14 shkurt 2021. Aq më tepër kur këto praktika kanë rezultuar vetëm me fuqizimin e strukturave ilegale të Serbisë në Kosovë", është thënë në komunikatën e përbashkët duke shtuar se Serbia dëshiron ta shfrytëzojë referendumin si mjet të shtrimit të sovranitetit të saj mbi Kosovën.

Kurse në deklaratën e përbashkët për medie të vendeve të Quintit është thënë se Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian mirëpresin referendumin kombëtar të Serbisë të 16 janarit për ndryshimet kushtetuese si një hap kyç për ta forcuar pavarësinë e gjyqësorit dhe për ta rritur transparencën dhe efektivitetin e institucioneve të

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 JANAR - Referendumi kushtetues i Serbisë nuk do të mbahet në territorin e Republikës së Kosovës. Ky është qëndrimi i përbashkët i institucioneve të Kosovës pas takimit me ambasadorët e vendeve të Quintit dhe me përfaqësuesit të

BE-së, të cilët kanë kërkuar që të lejohet grumbullimi i votave në Kosovë për referendumin serb. Të dielën, më 16 janar, Serbia mban referendumin për ndryshimin e Kushtetutës. Qytetarët e Serbisë do të deklarohen me "po" apo "jo" për një pyetje: "A jeni për konfirmimin e aktit për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Serbisë?".

shtetit të sundimit të ligjit. “Ne kemi inkurajuar të gjithë qytetarët e Serbisë që të marrin pjesë në referendum dhe besojmë se është e rëndësishme që votuesit me të drejtë vote të mund të votojnë në zgjedhje dhe referendume. Vërejmë me keqardhje se Qeveria e Kosovës nuk ka lejuar Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) të mbledhë fletëvotimet e votuesve me të drejtë vote që jetojnë në Kosovë për referendumin e ardhshëm në përputhje me praktikën e kaluar. Ne i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që t’i lejojë serbët në Kosovë ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në zgjedhje dhe procese zgjedhore në përputhje me këtë praktikë të vendosur”, është thënë në komunikatën e Quintit, duke kërkuar nga të dy shtetet që ta shmangin rritjen e tensioneve. “I bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë që të përmbahen nga veprimet dhe retorika që rritin tensionet dhe të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Është e rëndësishme që të dyja qeveritë të arrijnë përparim drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse që hap perspektivën e BE-së dhe rrit stabilitetin rajonal”, është thënë në deklaratën e përbashkët.

Opozita në vijë me qeverinë, kundër referendumit

Subjektet opozitare u kanë dhënë mbështetje institucioneve të Kosovës për të mos lejuar mbajtjen e referendumit serb në

territorin e Kosovës.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se mbajtja e referendumit të Serbisë në Kosovë është antikushtetuese. “Partia Demokratike e Kosovës konsideron se mbajtja e referendumit të Serbisë në Kosovë është antikushtetuese dhe kjo do të përbënte shkelje flagrante të sovranitetit të Republikës së Kosovës. Ka dallim esencial ndërmjet zgjedhjeve dhe referendumit, andaj është i papranueshëm lejimi i votimit në Kosovë për referendumin e një shteti fqinj”, ka deklaruar Krasniqi.

Në të njëjtën mënyrë është shprehur edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abixhiku. “Lidhja Demokratike e Kosovës e sheh të papranueshme mbajtjen e çfarëdo referendumi të një shteti tjetër në territorin e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Kosovës, ligjet e Kosovës dhe praktikatat ndërkombëtare janë të qarta në këtë drejtim. Prandaj ne presim dhe mbështesim respektimin e këtyre normave plotësisht”, ka shkruar Abdixhiku në llogarinë e vet në “Facebook”. Kurse sipas Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), përpjekja e Serbisë për referendum kushtetues në Kosovë është sulm mbi integritetin kushtetues të shtetit. “Pretendimi i Serbisë që të organizojë referendum kushtetues në territorin e Kosovës është sulm flagrant mbi sovranitetin dhe integritetin kushtetues të Kosovës, prandaj inkurajojmë dhe jemi në mbështetje të të gjithë atyre që e kundërshtojnë me forcë organizimin e këtij referendumi.



Kosova është shtet sovran dhe i pavarur dhe në territorin e saj nuk mund të organizohen kurrfarë referendumesh të shteteve të tjera, as referendumi i Serbisë i cili pastër është përpjekje për ushtrimin e sovranitetit nacional të Serbisë mbi Kosovën”, është thënë në reagimin e AAK-së.

As shoqëria civile nuk është pro mbajtjes së referendumit të Serbisë në Kosovë.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) konsideron që mbajtja e referendumi kushtetues të Serbisë në Republikën e Kosovës është në kundërshtim me parimet e demokracisë dhe respektit të ndërsjellë të secilit vend të Bashkimit Evropian.

Përmes një reagimi GLPS-ja thotë se nuk ekziston asnjë rast i mbajtjes së një referendumi kushtetues të një shteti tjetër. “Ne dëshirojmë të theksojmë që nuk ekziston asnjë rast i mbajtjes së një referendumi kushtetues të një shteti të huaj në territorin e një shteti tjetër në një mënyrë të tillë sikur të ishte një proces zgjedhor i

zakonshëm. Në kuptim të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (p. sh., rasti Pyv., France, 2005), e drejta e dikujt për të votuar për zgjedhjet e një shteti tjetër në territorin e shtetit ku banon nuk ekziston”, është thënë në reagime GLPS.

Sipas këtij grupi, kjo çështje është e qartë edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

“Një gjë e tillë është jashtëzakonisht e qartë në kuptim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 3, protokoll 1). Madje GLPS konsideron se Qeveria e Kosovës e ka detyrim kushtetues që të mos lejojë një proces votimi për një referendum kushtetues të një shteti tjetër, aq më pak për një shtet me një kushtetutë paragykuese dhe armiqësore ndaj territorit të Republikës së Kosovës. Prandaj, Qeveria e Kosovës jo vetëm që nuk duhet ta lejojë një proces të tillë, por e njëjta duhet ta arsyetojë veprimin e saj duke u mbështetur në mbrojtjen e parimeve kushtetuese dhe sovranitetin e plotë të shtetit të Kosovës, pavarësisht prej

deklaratave dhe presioneve të ndryshme nga jashtë”, ka vlerësuar GLPS-ja.

Kurse KMDLNj-ja ka ftuar opozitën që ta përkrahë qeverinë në kundërshtim të mbajtjes së referendumit të Serbisë. “Për KMDLNj-në nuk ka asnjë dilemë nëse Qeveria e Kosovës duhet të përkrahë për refuzimin e mbajtjes së referendumit për ndryshime kushtetuese të Serbisë e që rëndë e shkel sovranitetin e Kosovës, por paraqet shqetësim të madh qëndrimi oportunist i opozitës së Kosovës për këtë çështje. Të gjitha partitë opozitare, pa asnjë dallim, duhet të jenë në përkrahje të Qeverisë së Kosovës jo si individë, por si subjekte politike opozitare dhe duhet të dalin me qëndrim zyrtar. Nëse opozita me këtë heshtje mendon se do të përfitojë politikisht, e ka shumë gabim. Kur është në pyetje mbrojtja e integritetit territorial dhe ushtrimit të sovranitetit, opozita e çdo vendi normal jo që e përkrah qeverinë, por është prijatë e këtij kundërshtimi”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Shokët e burgut vizitojnë kryetarin e Malishevës, Ekrem Kastratin

Një grup shokësh, ish-bashkëvuajtës në burgjet e Serbisë, kanë vizituar kryetarin e komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Isak Shabani, Bislim Zogaj, Hajredin Hyseni “Dini” dhe Sadik Zeqiri e kanë vizituar kryetarin Ekrem Kastrati, me ç’rast i kanë uruar punë të mbarë dhe suksese gjatë mandatit katërvjeçar.

“Së bashku me Dinin, Bislimin e Sadikun vizituam kryetarin e Malishevës, Ekrem Kastrati. Ekremi i uruam punë të suksesshme gjatë mandatit të tij. Me Ekremin na lidh veprimtaria atdhetare. Jemi arrestuar bashkë dhe kemi përjetuar për më shumë se katër vjet tortura të ndryshme në burgjet e Serbisë, ndër to edhe masakrën në Dubravë.

Shoku im Ekrem, të priftë e mbara!”, ka shkruar deputeti Isak Shabani në llogarinë e vet në “Facebook”.



Universiteti 'Ukshin Hoti' organizoi ceremoni me rastin e pensionimit të profesor Ragip Gjoshit

PRIZREN, 14 JANAR- Në vlerësim për kontributin e prof. asoc. dr. Ragip Gjoshi, me rastin e pensionimit dhe punës së çmuar në shërbim të sistemit arsimor në Kosovë dhe kontributin e dhënë në dekadën e mbijetesës së shkollës shqipe, dhe për rezultatin e sukseset shumëvjeçare në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit të Kosovës dhe për edukimin e brezave të tërë në periudha të ndryshme të vështira për fatet e vendit, u mbajt ceremoni e organizuar nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit në bashkëpunim me Parlamentin Studentor të Universitetit "Ukshin Hoti". Me këtë rast,

përveç drejtuesve të universitetit dhe miqve të profesorit e studentëve, mori pjesë i gjithë personeli akademik dhe administrativ.

Me këtë rast mirënjohje ndau Rektorati, Fakulteti i Edukimit dhe Parlamenti Studentor. Në fund u shfaq edhe dokumentari "Një jetë e tërë në shërbim të shkronjave shqipe dhe në udhën e lirisë..." dedikuar veprimtarisë së profesorit që po pensionohet. Me këtë rast nga një fjalë rasti mbajtën zëvendësrektorja prof. asoc. dr. Albana Plakiqi-Milaimi, ish-ministri i Arsimit, prof. dr. Ramë Buja dhe ish-rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".



Kryetari i Skenderajt vlerëson humanizmin e Halil Kastratit




SKENDERAJ, 14 JANAR- Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka pritur në takim Halil Kastratin dhe bashkëpunëtorët e tij. Ai ka thënë se Kastrati është ndër më meritoret për zgjidhjen e çështjes së banimit të qindra familjeve në këtë komunë. Kryetari Nura ka theksuar se bashkëpunimi vetëm sa do të avancohet edhe më tej nëpërmjet projekteve të bashkëfinancimit për ndërtimin e shtëpive të reja për rastet e nevojshme. "Me Qytetarin e Nderit të Skenderajt, Halil Kastrati, dhe bashkëpunëtorët e tij dhe deputetin Mërgim Lushtaku,

ndër më meritoret për zgjidhjen e çështjes së banimit për qindra familje të komunës sonë, por jo vetëm, ndaj të cilit shprehim mirënjohje e konsideratë të lartë, për kontributin e tij dhe të bashkatdhetarëve zemërmirë, për zgjidhjen e problemit jetësor - atë të banimit, për familjet me kushte të rënda sociale dhe ekonomike. Bashkëpunimi vetëm sa do të avancohet edhe më tej nëpërmjet projekteve të bashkëfinancimit për ndërtimin e shtëpive të reja për rastet e nevojshme", ka shkruar Nura në llogarinë e vet në "Facebook".

U mbajt takimi i parë i Këshillit Organizues i Ditëve Përkujtimore "Flaka e janarit 2022"

RAHOVEC, 14 JANAR- Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka caktuar këshillin organizues për organizimin e aktiviteteve tradicionale kulturore dhe përkujtimore "Flaka e janarit 2022". Përbërja e këtij këshilli është kjo: Avni Morina, anëtar; Nora Boshnjaku, anëtare; Feriz Thaçi (përfaqësues nga OVL e UÇK-së), anëtar; Dervish Çadraku, anëtar; Blerta Gashi, anëtare; Shedat Ukaj, anëtar; Qemajl

Krasniqi, anëtar; Qëndresa Duraku, anëtare; Naser Dula, anëtar dhe Muharrem Morina, anëtar, ndërsa u kryesua nga Afrim Dina, kryesues, njëherësh drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Në këtë takim këshilli organizues shqyrtoi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin sa më të mirë të aktiviteteve tradicionale kulturore e përkujtimore "Flaka e janarit 2022".



Ministri i Mbrojtjes merr dozën e tretë të vaksinës kundër Covidit

PRISHTINË, 14 JANAR- Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka marrë dozën e tretë përforcuese të vaksinës kundër Covidit. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se mjeti më i

suksesshëm dhe efikas për luftimin e virusit është vaksinimi. "Ju bëj thirrje që së bashku të luftojmë pandeminë Covid-19 dhe në një të ardhme t'i kthehemi normalitetit. Mjeti më i suksesshëm dhe

efikas për luftimin e virusit është vaksinimi. Unë u vaksinova me dozën e tretë përforcuese të vaksinës. Ta ruajmë shëndetin tonë dhe të të tjerëve përmes vaksinimit", ka shkruar Mehaj.



Kosova regjistron 585 raste të reja me Covid

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 JANAR- Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të premten janë regjistruar 585 raste të reja me Covid-19 pas testimit të 6 589 mostrave.

Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 8.87 për qind.

Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar edhe se 57 persona janë shëruar derisa 3 339 persona janë ende aktivë me koronavirus.

Prej shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, autoritetet në Kosovë kanë regjistruar mbi 163 000 raste të infektimit. Prej këtyre, 2 994 persona kanë vdekur.

Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në mars të vitit të kaluar, prej atëherë janë dhënë mbi 1.7 milion doza të vaksinës. Qytetarët në Kosovë mund të

marrin vakcina të kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca".

Doza përforcuese e vaksinës mund të merret pas tre muajve të marrjes së dozës së dytë.

Bazuar në raportet e datës 14 janar 2022 nga klinikat Covid-19 në QKUK dhe spitalet e përgjithshme, në trajtim mjekësor janë 36 pacientë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 25 të tjerë post-Covid-19.

Me oksigjeno-terapi janë 25 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive një pacient.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se Omicroni është duke e shtuar intensitetin çdo ditë dhe është varianti dominues në qarkullim. "IKShPK-ja është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve



në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik. Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim, andaj IKShPK-ja u bën thirrje të gjithë qytetarëve që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të

përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim. Ndërsa rekomandojmë institucionet përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", ka njoftuar

IKShPK-ja.

Sipas këtij instituti, është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit Covid-19. "Omicroni është tejet ngjës, andaj mbani maskat në çdo vend, mbani distancën mbi dy metra edhe në mjedise të hapura edhe po qe se të gjithë bartin maska! Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për të parandaluar Covid-19, veçanërisht format e rënda të sëmundjes dhe vdekjet, ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë dhe sa më të shpejtë të popullatës nga mosha 12-vjeçare", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

MASHTI diskuton me partnerët zhvillimorë draftin e planit strategjik të arsimit 2022-2026

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 JANAR- Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) ka diskutuar të premten me partnerët zhvillimorë vendorë e ndërkombëtarë draftin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2022-2026, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve që

kanë të bëjnë me implementimin e këtij plani. Me këtë rast, ministrja Arbërie Nagavci ka theksuar rolin e rëndësishëm që kanë partnerët zhvillimorë për jetësimin e politikave të Ministrinë e Arsimit, por në përgjithësi për zhvillimin në fushën e arsimit si dhe të gjithë shoqërisë për pesë vjetët e ardhshëm. Pasi falënderoi partnerët zhvillimorë për mbështetjen e vazhdueshme

në arsim, ministrja Nagavci ka theksuar se puna e këtyre pesë vjetëve do të reflektojë në zhvillimet e gjithëmbarshme ekonomike dhe shoqërore për vendin tonë, ndërsa tha se ky dokument do të jetë baza që do të na mundësojë implementimin e këtij plani strategjik.

Ministrja Nagavci ka përmendur pesë fusha që janë caktuar si orientime kryesore në

programin e qeverisë për intervenim dhe zhvillim në sektorin e arsimit, duke filluar nga arsimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe i digjitalizuar, harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës, menaxhimi efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, arsimit i lartë me cilësi dhe integritet në harmoni me standardet ndërkombëtare, si

dhe përmirësimi i mjedisit për kërkime dhe inovacion.

Drafti i Planit Strategjik të Arsimit 2022-2026 është bazuar në këto pesë fusha, sikur edhe në shumë dokumente, ligje, strategji e hulumtime të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Planifikohet që ky dokument i rëndësishëm të dalë në konsultim publik dhe të finalizohet në muajin mars të këtij viti.

Kosova e dyta në rajon sa i përket rritjes ekonomike për dy vitet e ardhshme

PRISHTINË, 14 JANAR - Kosova do të jetë e dyta në rajon sa i përket rritjes ekonomike në dy vitet e ardhshme, duke u bazuar në parashikimet e Bankës Botërore. Pas rimëkëmbjes së madhe në vitin 2021, ekonomia globale sërish është ngadalësuar për shkak të shfaqjes së varianteve të reja të Covidit. Banka Botërore parashihet zvogëlim të rritjes globale deri në vitin 2023, gjë që rrit rrezikun edhe nga huamarrjet e ekonomive në zhvillim. Sipas të dhënave të prezantuara

nga "Radio Evropa e Lirë", vendi me rritjen më të madhe për dy vitet e ardhshme do të jetë Mali i Zi.

Kosova si e dyta për nga rritja ekonomike do të ketë rritje 4.1 për qind në vitin 2022 dhe 4.4 për qind në vitin 2023.

Banka Qendrore e Kosovës ka konsideruar se viti 2021 ka qenë vit i suksesshëm financiar në Kosovë.

Mbi 2.7 miliardë euro do të jetë buxheti i Kosovës për vitin 2022, 220 milionë euro apo 8.7 për qind më shumë krahasuar me buxhetin e vitin 2021.



Gastronomët e Gjilanit kërkojnë përkrahje nga komuna



GJILAN, 14 JANAR- Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur të premten në takim një grup gastronomësh të qytetit për t'i dëgjuar vështirësitë që ata kanë për punë në kushtet e pandemisë shkaku i kufizimeve të orarit dhe përdorimit të hapësirës. Sipas tyre, ka dallime nëpër komuna sa i përket zbatimit të masave kundër Covidit, sidomos ndaj lokaleve të cilat operojnë në lagjen "Dardania" të këtij qyteti, që janë shënjestër e inspeksionit dhe

policisë.

Njëherësh, ata kërkojnë nga kryetari i komunës që t'i shikojë mundësitë për ndonjë ndihmë financiare për gastronominë, pasi që kjo gjendje e ka goditur fort këtë sektor. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, pasi i ka dëgjuar me vëmendje shqetësimet e gastronomëve, ka thënë se do të bëjë gjithçka që është brenda kompetencave të tij që të kërkojë trajtim të barabartë për të gjithë gastronomët. "Unë nuk mund

të hyj në kompetencat e institucioneve të tjera, por si ndërmjetësues do të angazhohem për të përçarur te përgjegjësit ankesat tuaja", ka thënë kryetari Hyseni, ndërkohë që i siguroi gastronomët se për këtë çështje do t'i takojë komandantin e policisë si dhe përgjegjësin e inspeksionit. Përndryshe, ai ua rikujtoi gastronomëve se numri i të infektuarve është rritur ditë e fundit dhe se masat ekzistuese kundër Covidit duhet të respektohen.

Sekuestrohen 16 kartela grafike dhe tre aparate për prodhimin e kriptovalutave

FUSHË-KOSOVË, 14 JANAR - Policia e Kosovës ka njoftuar se njësitet e saj policore të Fushë-Kosovës, në bashkëpunim me ekipin e KEDS-it dhe zyrtarët e Doganës së Kosovës, në rrugën "Fahri Fazliu" në Fushë-Kosovë, kanë gjetur dhe sekuestruar tre aparate për prodhimin e kriptovalutave dhe 16 kartela grafike. Marrë parasysh procedurat ligjore lidhur me këtë rast, veprimet e mëtejme do të ndërmerren nga Dogana e Kosovës.

Ditët e fundit policia ka sekuestruar qindra aparate për prodhimin e kriptovalutave. Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që ta ndalojë prodhimin e kriptovalutave në të gjithë territorin e Kosovës. "Institucionet e rendit do ta ndalojnë prodhimin e aktivitetit në fjalë me mbështetje të të gjitha institucioneve relevante të cilat do t'i identifikojnë lokacionet e prodhimit të kriptovalutave", ka njoftuar ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli.



ZRRE-ja diskuton për vlerat e parametrevë për të hyrat e lejuara të FShU-së

PRISHTINË, 14 JANAR- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur mbledhjen e parë për këtë vit. Në këtë mbledhje bordi i ZRRE-së ka marrë vendim për vlerat e parametrevë të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në përcaktimin e të hyrave të lejuara të Furnizuesit me Shërbim

Universal (FShU) për periudhën 2022-2024. "Këto parametra përfshijnë shpenzimet operative, faktorin efikasitet, jetëgjatësinë e aseteve, borxhin e keq, marzhën me pakicë dhe faktorin ndarës të jobalanceve. Sot bordi ka marrë vendime për dhënien e autorizimeve për vetëkonsum edhe për pesë

aplikues për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike/solare, në kapacitet prej 262.61 kW. Pjesë e shqyrtimit nga bordi kanë qenë edhe disa çështje të tjera që ndërlidhen me funksionimin e sektorit si dhe të Zyrës së Rregullatorit për Energji", ka njoftuar ZRRE-ja.



Pse dëshirojmë të udhëtojmë: Historia e pa-rrëfyer se si u bëmë turistë



Pandemia aktuale ka mbajtur të mbyllur në shtëpi shumicën nga ne. Gjatë 2 viteve të fundit, industria e udhëtimeve është rrënuar. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit, fluksi ndërkombëtar i turistëve në muajt janar-shtator 2021, pati një rënie prej 76 për qind.

Ky është një ndryshim dramatik me vitet e fundit para pandemisë. Ne duam të udhëtojmë. Duam që t'i hipim avionit, tragetit, makinës. Çdo gjëje që do të na çojë diku tjetër përveç se aty ky ndodhemi. Por bllokimet dhe karantinat nuk kanë zbehur dëshirën tonë për të "parë vende".

Sipas "IPK International", një sondazh global tregoi se 60-90 për qind e të anketuarve të anketuar synojnë të udhëtojnë. Për evropianët, synimet për të udhëtuar jashtë vendit tani janë pothuajse 90 për qind kundrejt niveleve para-Covid. Për amerikanët, kjo shifër është rreth 70 për qind.

Për aziatikët, është 60 për qind, por me një tendencë të fortë rritëse muajt e fundit. Dhe e dini se çfarë është më interesante? Nga të gjithë personat që shprehën dëshirën për të udhëtuar, 81 për qind duan ta bëjnë këtë jo për biznes, as për të vizituar të afërmit, por për argëtim. Dëshira e pashuar për të qenë diku tjetër nga vendi ku je, është shumë e çuditshme. Njerëzit kanë

udhëtuar gjithmonë, dhe kjo është shumë e vërtetë. Përgjatë historisë, ata kanë udhëtuar për t'i shpëtuar klimës së ashpër, urisë ose luftërave.

Pra shumica e njerëzve nuk kanë udhëtuar kurrë me dëshirën e tyre, dhe sigurisht jo për kënaqësi, apo për të kaluar kohën e lirë. Njerëzit e parë që udhëtuan vullnetarisht ishin tregtarët. Në hebraishten e lashtë, fjalët "tregtar" dhe "udhëtar" janë sinonime...

Rrugës ndesheshin shpesh ushtarë dhe lajmëtarë, shtetarë dhe studiues, studentë dhe lypsarë, pelegrinë dhe njerëz të kërkuar nga autoritetet. Por mbi të gjitha ishin tregtarët, ata që merreshin me tregtinë e erëzave, arin, mëndafshit, armëve dhe perlave.

Udhëtimi, si qëllim në vetvete, ishte i panjohur deri në shekullin XVIII. Atëherë nga lindi ideja e udhëtimit për kënaqësi, turizmi? Si u bëmë turistë? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, duhet të gërmojmë më thellë në histori. Fjalori anglisht i Oksfordit, e daton përdorimin e parë të termit "turne" (tour) përafërsisht në vitin 1670.

Me origjinë nga frëngjishtja e vjetër, ky term do të thotë "kthesë" dhe i referohet gjithashtu një lëvizjeje rrethore; pra një udhëtim që rikthehet në pikën e tij fillestare. Dhe në fillimet veta ai ishte një ekskursion edukativ për të pasurit,

të ashtuquajturat "Grand Tour".

Të rinjtë e shtresave të pasura angleze, dërgoheshin në vende të gjera të Evropës kontinentale si pjesë e arsimit të tyre. Shpesh vizitat e tyre zgjasnin të paktën një vit, në mos me vite. Por gjërat nisën të ndryshonin. Duke nisur nga vitet 1780, shtresat e mesme e profesionistëve përbente pjesën më të madhe të "Grand Tour", duke përfaqësuar 60 për qind të udhëtarëve. Ndërkohë në vitin 1811 ndeshim përdorimin e parë të fjalës "turizëm" (tourism). Por kënaqësia nuk konsiderohej ende si një arsye e rëndësishme për të udhëtuar. Por çfarë ndryshoi? Nga fundi i shekullit XVIII-të, në Evropë nisi të shpërbëhej rendi i vjetër feudal.

Pra po perëndonte bota e padronëve dhe bujkrobërve, duke i lënë botës së sapokrijuar të borgjezisë dhe proletarietit. U shpërbënë çifligjet dhe mbretëritë, dhe lindën shtetet kombëtare.

Këto i kthyen të gjithë në qytetarë të barabartë. Në parim, çdo qytetar u bë i barabartë (në praktikë, në disa vende, do të duhej më shumë se një shekull tjetër që e drejta e votës t'u shtrihej edhe grave). Dhe nacionalizmi u dha njerëzve një arsye të re për të udhëtuar, për të parë pjesën tjetër të vendit.

Shumë njerëz nuk mund ta shihnin fizikisht të gjithë vendin e tyre, por sigurisht që mund të

shihnin monumentet e mëdha kombëtare, që janë paraqitjet fizike të kombit. Ndaj lindën muzetë kombëtarë, si një institucion i ri për të mbledhur, kategorizuar dhe shfaqur fuqinë e një kombi ose perandorie.

Kombet u përpoqën të ndërtonin monumente kombëtare, për të theksuar përparimin e tyre kombëtar shkencor dhe industrial. Kështu e famshmjia Kulla Eifel në Paris përfundoi në vitin 1889. Statuja e Lirisë iu dhurua SHBA-së nga Franca në vitin 1886, dhe u shpall si monument kombëtar në vitin 1924.

Monumentet kombëtare, vazhduan të kopjohen në të gjithë botën. Po kështu lindën edhe parqet kombëtare. Në 1864, u krijua hapësira tokësore e parë e mbrojtur nga shteti, kur presidenti amerikan Abraham Linkoln nënshkroi ligjin për mbrojtjen e Luginës së Josemitit. Parku Kombëtar i Jelloustounit në SHBA, u shpall parku i parë kombëtar në botë në vitin 1872.

Sot në mbarë botën ka më shumë se 4000 parqe kombëtare. Gjithsesi, njerëzit duhej të nxiteshin të hidhnin hapat e parë si turistë, në një botë tërheqëse që po zgjerohej me shpejtësi. Plazhet ishin dikur mjedise të frikshme. Ndaj plazhet e egra duhej të shndërroheshin në vendpushime, ku njerëzit të shijonin diellin dhe

detin.

Shkrimtarët romantikë, artistët dhe borgjezia e sapo-shfaqur ndihmuan në krijimin e një narrative të re të plazhit si një vend energjik, për t'u shëruar dhe ripërtëritë fizikisht dhe shpirtërisht.

Biznesmenët ndërhynë menjëherë për të krijuar produkte dhe shërbime të reja.

Angezi Tomas Kuk ishte një nga këta pionierë. Ai ishte organizator Ekspozitës së Madhe të Londrës në vitin 1858, kur dhjetëra mijëra njerëz të klasës punëtore udhëtuan me tren për të marrë pjesë në të. Po ashtu Kuk ishte pionier edhe i atij që ne sot e quajmë turizëm ndërkombëtar. Ai krijoi turne në qytete të tilla si Parisi, Brukseli dhe Këlni, dhe në fund në mbarë botën.

Kuk themeloi kompaninë e udhëtimit "Thomas Cook & Son". Ajo nuk ekziston më sot, por risitë e Tomas Kuk vazhdojnë të jetojnë, broshurat udhërrëfyese, rezervimet e udhëtimit, madje edhe paraardhësit e çeqeve të udhëtarëve (që sot janë zëvendësuar nga kartat e kreditit, të cilat nga ana e tyre po sfidohen nga aplikacionet globale të pagesave).

Pa këto risi, nuk ka gjasa që ne të jemi në gjendje të udhëtojmë aq shumë sa sot. / *History of Yesterday – Bota.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sot dy ndeshje, nesër derbi Prishtina - Peja

PRISHTINË, 14 JANAR - Xhiroja e 16 në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll do të dhurojë ndeshje shumë interesante. Sfida më interesante shihet mes rivalëve të vjetër të basketbollit të Kosovës, Sigal Prishtinës dhe Pejës. Prishtinasit kanë tetë fitore dhe shtatë humbje, kurse pejanët dhjetë fitore e pesë humbje, andaj pritet një përballje shumë rivalizuese në kryeqytet, siç ka ndodhur edhe në takimet e mëparshme mes këtyre dy skuadrave. Në përballjet e këtij edicioni të dyja skuadrat shënuan nga një fitore si mysafirë ndaj njëra-tjetrës. Takim shumë interesant pritet edhe në mes të Trepçës dhe Prizrenit 16, dy skuadra që kanë ambicie të mëdha. Mitrovicasit kanë dhjetë fitore dhe pesë humbje, ndërsa prizrenasit nëntë fitore dhe pesë humbje. Në dy takimet e këtij edicioni mes këtyre dy skuadrave fitore kanë shënuar mitrovicasit. Rahoveci të shtunën do të ndeshet me Dritën. "Vreshtarët" kanë tri

fitore dhe 11 humbje, madje dy fitore i kanë ndaj gjilanasve, që është skuadra e vetme në elitë pa fitore, me 15 humbje. Lideri dhe kampioni Golden Eagle Ylli sfidohet nga Bashkimi. Therandasit kanë 11 fitore dhe katër humbje, ndërsa prizrenasit tetë fitore dhe shtatë humbje. Kampionët shihen favoritë në këtë përballje, kurse mysafirët nuk

SUPERLIGA E MESHKUJVE - JAVA 16

Të shtunën takohen:
17:00 Rahoveci - Drita
19:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Peja
19:00 Trepça - Prizreni 16

SUPERLIGA E FEMRAVE / JAVA 11

Të dielën takohen:
13:00 Trepça - Penza
13:00 Vëllaznimi - Bashkimi
14:00 Prishtina - Kastrioti



udhëtojnë me flamur të bardhë dhe do të përpiqen të rikthehen me rezultat pozitiv nga Theranda.

Fillon stinori pranveror në Superligën e Femrave

Të dielën do të zhvillohet xhiroja e 11-të në Superligën e Femrave. Prishtina, që është e vetmja skuadër pa humbje në elitën e femrave, do të ndeshet me Kastriotin që është e vetmja skuadër pa fitore në elitë, me dhjetë humbje në dhjetë ndeshje. Kampionia e Kosovës, Penza, do të sfidohet nga Trepça. Skuadra pejane ka tetë fitore dhe dy humbje, kurse mitrovicasit kanë tri fitore dhe shtatë humbje. Vashat pejane shihen favoritë në këtë përballje. Bashkimi, që ka gjashtë fitore dhe katër humbje, do të ndeshet me Vëllaznimin, ku skuadra kuqezi ka tri fitore dhe shtatë humbje. Prizrenaset kanë bërë disa përforsime dhe kanë ambicie të mëdha për këtë edicion.

Kiana Kryeziu edhe zyrtarisht përfaqëson Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore

PRISHTINË, 14 JANAR - Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore do ta përfaqësojë skitarja Kiana Kryeziu e cila bëhet sportistja e parë që do ta përfaqësojë Kosovën në këto lojëra. Kiana e ka fituar normën olimpikë për "Beijing 2022", kurse normën e ka siguruar edhe Albin Tahiri. "Krenarë pa fund. Skitarja Kiana Kryeziu bëhet sportistja e parë që do ta përfaqësojë vendin tonë në Lojërat Olimpikë Dimërore. Ajo ka fituar normën olimpikë për Lojërat Olimpikë Dimërore 'Beijing 2022'. Së bashku me Kianën, në Lojërat Olimpikë



Dimërore 2022 Kosova do të përfaqësohet edhe me skiatorin Albin Tahiri, i cili ka siguruar normën olimpikë në gara të

mëhershme. Shumë urime Kianës, Albinit dhe gjithë komunitetit të skitarisë!", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

Kosova sonte përballlet me Belgjikën

PRISHTINË, 14 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll është ende në garë për të kaluar në fazën e dytë të kualifikimeve për Botërorin 2023. Të enjten është luajtur ndeshja në mes të Greqisë dhe Belgjikës, ndërsa fitore kanë shënuar grekët me rezultat 42:24. Ky rezultat e lë në garë Kosovën për pozitën e dytë, që siguron avancimin tutje. Të mërkurën Kosova fitoi me rezultat 26:24 ndaj Turqisë. Pas pesë xhirove, në grupin e parë udhëheq Greqia me 10 pikë, Turqia është e dyta me 4 pikë, ndërsa Kosova e Belgjika i kanë nga 3 pikë. Të shtunën (20:15) Kosova luan në udhëtim ndaj Belgjikës, ndërsa ndeshja



Turqi - Greqi është të dielën. Kosovës i duhet fitorja për të mbetur në garë. Dhe për kualifikim, pos fitores, i duhet që Greqia ta mposhtë Turqinë. "Dardanët" kanë vazhduar përgatitjet për këtë ndeshje dhe të premtën kanë udhëtuar drejt Belgjikës.

Drejtuesit e KOK-ut presin në takim drejtuesit e FBBFK-së dhe FBSH-së

PRISHTINË, 14 JANAR - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, kanë pritur udhëheqësit e Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnessit të Kosovës (FBBFK) dhe Federatës së Bodybuildingut të Shqipërisë (FBSH-së). I pranishëm ishte

edhe kampioni i botës në Kupën Diamond, bodybuilderi shqiptar Marin Meksa, i cili u përgëzua nga drejtuesit e KOK-ut për suksesin e arritur. "Të tria palët kanë diskutuar për mundësi të ndryshme të bashkëpunimit në të mirë të bodybuildingut dhe fitnessit. Drejtuesit e KOK-ut kanë

shprehur vullnetin dhe gatishmërinë që bashkërisht edhe me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar të përkrahin këtë sport për zhvillimin e mëtejshëm dhe për avancimin drejt sukseseve të reja në arenën ndërkombëtare", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



Benzema, lojtari i vitit në Francë

PARIS, 14 JANAR - Karim Benzema ishte futbollisti më i mirë francez në vitin 2021. Numri nëntë festoi golin e tij të 302-të të Real Madridit kundër Barcelonës në gjysmëfinalen e Superkupës së Spanjës të së mërkurës

mbrëma, duke vazhduar formën e shkëlqyer që po shijon me klubin e tij. Kjo formë ishte e qëndrueshme gjatë gjithë vitit 2021 dhe madje i dha atij një tërheqje në skuadrën e Francës për "Euro 2020". Aq mbresëlënëse ishte

forma e tij sa 'France Football' e ka cilësuar si futbollistin më të mirë francez të vitit 2021, përpara edhe Kylian Mbappe. Ky i fundit mirëpriti dhe festoi fitimin e çmimit Benzema, madje mbi veten dhe N'Golo Kante. "Unë jam bërë numri 9

që kam dashur gjithmonë të jem", ka thënë Benzema në një intervistë për "France Football". Me 23 gola në 26 ndeshje deri më tani këtë sezon, dhe nëntë asistime gjithashtu, Benzema nuk po tregon shenja të ngadalësimit



me "Los Blancos" dhe ai mund të vazhdojë të arrijë edhe më shumë në 2022-n.

Messi: Shërimi nga Covidi më mori më shumë kohë sa kam menduar

PARIS, 14 JANAR - Argjentinasi ka folur për herë të parë prej që ai doli pozitiv me virusin Covid-19. Argjentinasi nuk ka mundur të kthehet në kohë në Evropë pas periudhës së pushimeve pasi që mori virusin, duke bërë që ai mos të luajë për Paris Saint-Germain ende këtë vit. Tani sulmuesi ka thyer heshtjen e tij në lidhje me këtë gjë duke postuar në "Instagram" një foto nga shtëpia e tij në Paris. "Siç e dini, kam Covid dhe dëshiroj t'ju falënderoj të gjithëve për mesazhet që më keni dërguar", ka shkruar Messi. "Dëshiroj t'ju tregoj që mori më shumë kohë sesa kam menduar që të shërohem, por jam pothuajse i shëruar dhe shpresoj që sa më shpejt të kthehem në fushë. Jam stërvitur ditët e fundit për të arritur në 100 për qind. Ka shumë sfida të mëdha që na



presin këtë vit dhe shpresoj që ta shohim njëri-tjetrin së shpejti. Ju faleminderit të gjithëve!", ka shtuar Messi. Paris Saint-Germaini dhe Federata e Futbollit e Argjentinës janë pajtuar që Messi të mungojë në

ndeshjet e ardhshme të Kombëtares së Argjentinës kundër Kilit dhe Kolumbisë më 27 janar dhe 1 shkurt respektivisht. Megjithatë, do të jetë Messi që do ta thotë fjalën përfundimtare.

Giannis fiton duelin me Curryn, Memphisi synon kreun e NBA-së

MEMPHIS, 14 JANAR - Kampionët e Milwaukeees fituan me rezultat 118-99 ndaj Golden States në një përballje mes dy ekipeve pretendente për titull këtë sezon në NBA. Diferenca në fushë mes dy ekipeve ishte e madhe, me Bucksin që e meritoi fitoren. Lider në fushë ishte MVP, Giannis Antetokounmpo, autor i një "triple double", me 30 pikë, 12 rebounde e 11 asistime (Curry vetëm 12 pikë). Gjithsesi, skuadra më e mirë aktualisht në NBA mbetet ajo e Memphisit, që korri fitoren e 11-të radhazi. Memphisi fitoi 116-108 ndaj



Minnesotas, ndeshje ku u dalluan Bane me 21 pikë e Jacksoni me 20 pikë. Gjithsesi, diferencën e bëri stoli i Memphisit, nga erdhën 48 pikë. Zhgënjën sërish ekipi i Brooklynit, që u mund thellë në shtëpi nga Oklahoma me rezultat 130-109. Humbje që zbret

Brooklynin në vendin e tretë në Lindje. Për Oklahomën u dalluan Shai me 33 pikë dhe Dorti me 27 pikë, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Hardenit për Netsat. Fiton edhe Denveri me rezultat 140-108 ndaj Portlandit, me dyshen Jokiç-Barton, që së bashku realizuan 41 pikë.

REZULTATET

| | |
|--------------------------|---------|
| Milwaukee - Golden State | 118-99 |
| Memphis - Minnesota | 116-108 |
| New Orleans - Clippers | 113-89 |
| Brooklyn - Oklahoma | 109-130 |
| Denver - Portland | 140-108 |

SHKURT

Melos Zenunaj rikthehet te Dukagjini

Futbollisti Melos Zenunaj rikthehet në skuadrën e Dukagjinit nga Klina. Melosi hapat e parë në futboll i mori pikërisht në këtë klub, derisa në sezonin vjeshtor ishte pjesë e skuadrës së Flamurtarit nga Prishtina. "Futbollisti i cili edhe hapat e parë në futboll i kishte nisur pikërisht me Klubin e Dukagjinit, rikthehet përsëri në vendlindjen e tij. Melosi për tri vjet radhazi ishte paraqitur te skuadra e Flamurtarit nga Prishtina, me të cilën është aktivizuar edhe në sezonin vjeshtor. 'Melo' luan pothuajse në të gjitha pozitat e vijës së fundit të mbrojtjes, ndërsa në i urojmë mirëseardhje në '18 Qershori', duke i dëshiruar shumë suksese me logon dhe fanellën me të cilën ai është zhvilluar si futbollist", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Gjokoviqi sërish do të dërgohet në mbajtje

Tenisti serb Novak Gjokoviq të shtunën do të dërgohet sërish në mbajtje. Gjokoviq do të kalojë më shumë kohë në mbajtje, derisa sfida e tij ligjore vazhdon në gjykatë. Atij iu anulua viza për herë të dytë nga autoritetet australiane për shkak se është i pavaksinuar, shkruan "The Mirror". Ai do të intervistohet të shtunën në orën 08:00 të mëngjesit nga zyrtarë të Forcave Kufitare Australiane në zyrat e tij të avokatëve.

Bayerni kërkon Sulen

Barcelona po synon të bëjë një tjetër lëvizje që do ta përforconte skuadrën në repartin e mbrojtjes. Katalanët kanë vënë në shënjestër lojtarin e Bayern Munchenit dhe reprezentuesin e kombëtares së Gjermanisë, Nicklas Sule. Barça synon ta marrë lojtarin si transferim të lirë, me kontratën e këtij të fundit që po shkon drejt fundit. Sule është në dijeni për interesimin e Barcelonës, por situata nuk është aq "e nxehtë". Martinez i Ajaxit dhe Christensen i Chelseas janë alternativat e Barcelonës, pa harruar edhe Cesar Azpilicueta.

Carvajali infektohet me Covid-19

Skuadra e Real Madridit ka njoftuar se Dani Carvajal rezultoi pozitiv me Covid-19. Prandaj, mbrojtësi i djathtë do ta humbasë finalen e Superkupës së Spanjës, të planifikuar për të dielën në orën 19:30 në Jeddah kundër Athletic Bilbaos. Kjo e fundit mbrëmë e mposhti në gjysmëfinale skuadrën e Atletico Madridit, derisa "Los Blancos" eliminoi Barcelonën me rezultat 2-3.

Interi shënjestron Dybalan

Skuadra e Interit po shkëlqen në fushë, por gjithsesi puna për ta përforcuar ekipin vazhdon. Drejtori sportiv Marota njihet si ekspert i

merkatos me parametër zero dhe ka piketuar lojtarin që do të afrojë. Ai synon të "grabisë" nga Juventusit, Paulo Dybalën. Argjentinasi i skadon

kontrata në fund të sezonit dhe nuk ka vendosur ende të rinovojë. Marota e ka pikë të dobët sulmuesin pasi e ka kërkuar dhe më parë.

Gjithsesi Interi më parë duhet të lirohet nga rrogat e disa lojtarëve, ku më të kuotuarit janë Vidal dhe Vesino. Nëse Dybala nuk rinovon me Juven


atëherë Interi është gati të futet në garë për t'i marrë shërbimet e tij. 28-vjeçari kërkohet edhe nga Barcelona dhe Tottenhami.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets



Ftesë për Ankand Publik Rishpallje

Datë 14.01.2022

Referenca: AAPSK - 001/2022

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

| Nr | Përshkrimi | Sasia/copë | Çmimi Fillestar Total | Çmimi nga ofertuesi Total |
|----|---|------------------------|-----------------------|---------------------------|
| 1 | Pllakë Mermeri me dimension 0.4X0.6m dhe 15 mm trashësi | 4,890.24m ² | 36,119.81 € | |
| 2 | Guri Dekorativ me dimension 0.05X0.3m | 355.91m ² | | |
| 3 | Gilinder Dekorativ (Shtylle) | 1,114.00 copë | | |

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 21.01.2022 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 21.01.2022, prej orës 09:00-10:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se, në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Sektori i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

PËR SIGURINË E JUAJ DHE PUNONJËSVE TANË, JU LUSIM QË GJATË PJESËMARRJES NË ANKAND TË MBANI MASKËN KUNDËR COVID19; MBANI DISTANCËN DHE DEZINFEKTONI DUART RREGULLISHT!

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Elijoni” Sh.P.K, me pronar Driton Rashica, nga Studime e Ultë e Vushtrisë bënë shuarjen e biznesit me numër: 811106592 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Elijoni”, d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom broja: 811106592 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Elijoni”, L.L.C, has taken the decision to quit its business with number: 811106592, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Publikuar në gazetën “Epoka e re” Prishtinë, 15.01.2022

LAJMËROJMË

Bashkëpronarët ARBEN (Sami) MALOKU, RAMADAN (Gani) KELMENDI, ELVIS (Ebib) HALLAQI, FAIK (Xhemajl) MALIQI, SHKELZEN (ENVER) KRASNIQI, JANUZ (Sahit) KELMENDI, SAHIT (Ramadan) PAÇARIZI, DASTID (Afrim) PAÇARIZI, TURKIJANA (Adem) GJAKMANI, FLORENT (Hajdar) JANQISHTA, MEHMET (Demir) PAÇARIZI, RAIF (Adem) KUSHAJ, SEHARE (Sahit) PAÇARIZI, SAMI KRYEZIU, SELIM (Rakip) AHMETI, SOKOL (Ramadan) NUHAJ, FLAMUR (Hajrullah) GASHI, ISAK ISAKU, SELAUDIN (Sali) TABAKU, SINAN GASHI, MUHAMET (Sali) MORINA, FLORIM (Tahir) JAHAJ,

si bashkëpronarë ligjor të ngastrës kadastrale me numër P-71813046-01982-0, që ka sipërfaqe të përgjithshme prej 12920m², me kulturë Livadh i klasës 3, vendi i quajtur “Ograde-Izmexhu Jaruga”, Zona Kadastrale Lubizhdë, po i SHES - pjesën time bashkëpronësore. Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmëtohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. Drini i Bardhë nr.20. - Prizren. Njëherit informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 34,000.00 € (tridhjetekatër mijë euro).

Telefoni kontaktues: +383 (0) 48/334-774

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ N.SH. Idra-EHT-IN shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70952327, nr. unik identifikues 811206938 nr fis. 600962692
- ▶ Xhylnaze Cena shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- ▶ Gezim Duraku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I- V dhe VI - IX shfmu " Bajram Curi " Krushe e Madhe.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

